



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.643/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.H. Villa Venera me seli në lagjen Veternik në Prishtinë, me pronar B.M., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokatët Petrit Dushi dhe Fatlum Podvorica nga Prishtina, kundër të paditurës së parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arban Mehmeti, dhe të paditurit të dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Auron Kadrija, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.1536/22 datës 10.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.05.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar Ankesa e paditësit N.H. Villa Venera me seli në lagjen Veternik në Prishtinë dhe Ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.1536/22 i datës 10.10.2023, VËRTETOHET

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar K.E.nr.1536/22 të datës 10.10.2023, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.H. Villa Venera dhe Detyrohet i padituri i parë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KEDS-SHA, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datë 29.08.2015, si pasojë e djegies së objektit Restaurant Villa Venera, t,ia paguaj paditësit në emër të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumën prej 181,246.79€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë 05.11.2015, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë

së paditësit N.H. Villa Venera, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i parë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KEDS-SH.A, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datën 29.08.2015, si pasojë e djegies së objektit Restaurant Villa Venera, t,ia paguaj paditësit në emër të kompensimit të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumën prej 56,640.01€, në emër të dëmit si pasojë e djegies së enterierit me pajisje teknologjike dhe inventarit shumën prej 79,042.50€ si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 58,155.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive, III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.H. Villa Venera, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datën 29.08.2015, si pasojë e djegies së objektit Restarurant Villa Venera, t,ia paguaj paditësit në emër të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumën prej 237,886.80€, në emër të dëmit si pasojë e djegies se enterierit me paisje teknologjike dhe inventarit shumën prej 79,042.50€, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 58,155.00€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive, IV. Detyrohet i padituri i parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, që paditësit t,ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 9,862.50€ në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesë përfaqësuesit e autorizuar të palës paditëse dhe palës së paditur.

I autorizuari i paditësit, me ankesë, kërkon që të vërtetohet pika I e aktgjykimit KE.nr.1536/22 i datës 10.10.2023 të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, ndërsa të ndryshohet pika e II të aktgjykimit KE.nr.1536/22 i datës 10.10.2023, ashtu që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e paditësit N.H. Villa Venera me seli në Prishtinë si e bazuar, dhe të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit sa i përket pikës II të aktgjykimit në tërsi dhe të Detyrohet e paditura e parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, që paditësit NH Villa Venera, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me 29.08.2015-djegies së enterierit me paisje teknologjike dhe inventarit, paditësit t,ia paguaj shumën prej 79,042.50€ si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 58,155.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive

Pala e paditur në ankesën e saj, kundërshton aktgjykimin e atakuar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Aprovohet ankesa e paditurës si e bazuar, te priset aktgjykimi KE nr.1536/22 dt.10.10.2013, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose vet ta vendos çështjen duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Në përgjigjen në ankesë i autorizuari e paditësit i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërsi si të pabazuar ankesën e paditures kurse ankesën e përfaqësuesit të paditësit ta aprovoj si të bazuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankes, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N.H. Villa Venera me seli në lagjen Veternik në Prishtinë, me datën 05.11.2015 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës së parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, dhe të paditurit të dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material në vlere prej 370.000€, të shkaktuar nga rasti i zjarrit datës 29.08.2015, në restorantin Villa Venera në lagjen Veternik në Prishtinë, dhe në precizimin e kërkesëpadisë së datës 29.06.2020 i autorizuari i paditësit, ka kërkuar nga gjykata kompensimin e dëmit si: në emër të dëmtimit material për punët ndërtimore shumë prej 237,886.80€, në emër të dëmtimit të enterierit me paisje teknologjike dhe inventarin komplet në shumë prej 79,042.50€, në emër të fitimit të humbur për periudhën shtator 2-15-mars 2019 shumë prej 58,155.00€, ose kompensimin e dëmit të shkaktuar në shumë prej 375,084.30€, me kamatë ligjore 8% prej datës 29.08.2015 ditës kur është shkaktuar dëmi, e deri në pagesën definitive.

Më tej në seancat gjyqësore të autorizuarit e paditësit, kanë deklaruar se mbeten pranë precizimit të kërkesëpadisë duke theksuar se paditësi e ka argumentuar bazueshmërin e kërkesës së tij, e vërtetuar nga hulumtimi i zjarrit, raportet e policisë, ekspertizat e elektros të punuara nga eksperti G.P., grupi i eksperteve të ndërtimtarisë, si dhe ekspertizat financiare. Paditësi shton se shkaktari i djegies së objektit ka qenë rryma elektrike e konstatuar nga raporti i policisë nr.2015/AD?2623 dt.30.08.2015, raporti mbi hulumtimin e shkaktarit të zjarrit nga Agjencia e menaxhimit emergjent e MPB-së nr.22/2015 dt.01.09.2015, me të cilin është vërtetuar se në objektin Villa Venera ka pasur probleme me tension i cili përherë ka qenë përmbi 250volt, gjithashtu nga ky raport vërtetohet se pronari i paditësit i ka njoftuar dy here përgjegjësit e të paditurit të parë KEDS, të cilët pas daljes në objekt kanë matur tensioni i cili edhe në ato momente ka qenë 250 volt. Paditësi thekson se sipas ekspertizës dt.28.01.2018 të ekspertit G.P. dhe grupi i ekspertëve R.H., Xh.S. dhe M.B., në ekspertizën e muajit tetor 2018, kanë konstatuar se shkak u shpërthimit të zjarrit kanë qenë luhajtjet e shkaktuara të tensionit të furnizuar nga trafo shtyllore përkthësisht të KEDS-it, që ka qenë pika furnizuese e objektit të djegur me energji elektrike, ku si pasojë e mbitensionit furnizues që ka ardhur nga tarfo 10/0.4KV për një periudhe të gjatë kohore, prandaj përgjegjësia për zjarrin e shkaktuar bie mbi të paditurat, për shkak se të njëjtat nuk kanë furnizuar me energji elektrike me tensionin e parapare normal, por çdo here kanë furnizuar me mbi tension. Demi i shkaktuar është vërtetuar sipas ekspertizave ndërtimtarisë të punuara nga S..B. dhe A.P., ekspertiza financiare nga eksperti A.G. dhe plotësimi i saj si dhe grupi i ekspertëve të ndërtimtarisë N.M., B.E. dhe Sh.Q.. Paditësi ka dorëzuar fletën poseduese si provë se është vërtetuar pronësia e tij e objektit të djegur, lidhur me pretendimet e legjitimitetit aktiv. Në fund i propozon gjykatës që të aprovohet padia e paditësit sipas precizimit të kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar nëse gjykata gjen si përgjegjëse vetëm të paditurën e parë ta obligoj të njëjtën për kompensimin e dëmit ose nëse gjykata gjen si përgjegjëse të paditurën e dytë ta detyroj të njëjtën për kompensimit e dëmit, ose ti detyroj të paditurat që në mënyrë solidare t,ia

kompensojnë paditësit në emër të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumë prej 237,886.80€, në emër të dëmit si pasojë e djegies së enterierit me pasje teknologjike dhe inventarit shumë prej 79,042.50€ si dhe në emër të fitimit të humbur shumë prej 58,155.00€ të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive, shpenzimet i ka kërkuar sipas specifikimit në parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë.

I padituri i parë Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore, kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, se padia është mbështetur në pretendimet të cilat dështojnë ta përmbushin një parakusht themelor mbi të cilin do të argumentohet bazueshmëria e tyre. I padituri në këtë rast nuk ka përgjegjësi për dëmin e pretenduar, sepse me dispozitën e nenit 158 të LMD-së, i padituri lirohet nga përgjegjësia në rast kur provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak së ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i tillë nuk ka mundur të parashihej, të mënjanohet ose evitohet, dhe nëse provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose personi i tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur të shmang. Nga aktgjykimi i ankimuar EK.C.nr.495/15 i Gjykatës së Apelit, është konstatuar se nuk ishte vërtetuar nëse përgjegjësia i takon palës së padituri konform kodit të shpërndarjes së ZRRE-së, edhe në procedurën e rigjyimit pala paditëse nuk ka arrit ta argumentoj se e paditura ka përgjegjësin e mirëmbajtjes, rregullimit dhe i operimit me trafo stacion nga kur furnizohet paditësi. Nga provat e lëndës rezulton se trafostacioni nga ku është furnizuar paditësi me energji elektrike nuk është i të paditurës. Me pëlqimin elektroenergjetik dt.22.03.2000 nr.protok.742/1 trafostacioni është ndërtuar S.O. pronar i fabrikës së betonit Ars Company-Fabrikë e Betonit ndërsa N.M. që është vëllai i pronarit të paditësit B.M. sipas kërkesës së tij me dt.19.11.2003 me nr.protok. 1005 nga KEK-u, për objektin Villa Venera i lëshohet pëlqimi elektroenergjetik për tu furnizuar me energji elektrike nga TS Betonjerka, po ashtu është lëshuar Pëlqimi elektroenergjetik për rritjen e fuqisë angazhuere. I padituri ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë sipas dy ekspertizave të ndërtimtarisë, ndërsa nga grupi i eksperteve të ndërtimtarisë ka vërejtje sa i përket inkorporimit të kriterit të amortizimit të objektit në llogaritje, ku vlera reale e objektit duhet të ishte në shumë prej 130,244.00€. Gjithashtu ka kundërshtuar kompensimin në emër të fitimit të humbur pasi nga ekspertiza e fundit e I.P. ekspert financiar, është konstatuar se paditësi në periudhën 29.08.2014-21.03.2016 ka operuar me bilanc negativ, përderisa ekspertiza paraprake e eksperti A.G. ka qenë në kundërshtim me gjendjen faktike, duke bërë llogaritje të gabuar marrë për bazë periudhën prej 5 viteve para se të kishte ndodhur ngjarja. I propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

I padituri i dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, gjatë seancave gjyqësore, dhe fjalën përfundimtare ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se në këtë çështje kontestimore të paditurës së dytë i mungon legjitimiteti real pasiv në procedurë, sepse e paditura e dytë nuk ka në pronësi dhe as nuk posedon rrjetin elektrik dhe gjithashtu nuk posedon asnjërin nga stabilimentet elektrike, dhe se e njëjta bën vetëm furnizimin me energji elektrike, që vërtetohet edhe me kodin e

shpërndarjes ku janë definuar detyrat e të paditurave. I propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj në tërsi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas Aktgjykimit EK.C.nr.495/15 datës 02.11.2020 të Gjykatës së Apelit, pas administrimit të provave në seancën gjyqësore datës 10.10.2023, e mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndëgjyqëse, ka marr aktgjykimin ankimor, me të cilin ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, gjendjen faktike lidhur me kontestin e shkaktimit të dëmit të zjarrit dhe vlerën e dëmit të shkaktuar nga zjarri në objektin e paditësit, e bazon në vërtetimin nr.protok. 112 dt.29.09.2015 i lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Raportin nr.7446-2015 i KEDS-it, ekspertiza e elektros nga eksperti G.P. dt.28.01.2018, ekspertiza e grupit te eksperteve R.H., Xh.S. dhe M.M., tetor 2018, Pëlqimi elektroenergjetik nr.742/1 dt.22.03.2000 i KEDS-it, ekspertiza e ndërtimtarisë dt.18.01.2019, nga eksperti S..B., ekspertiza financiare e datës 22.03.2019 nga eksperti A.G., ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve të ndërtimtarisë N.M., B.E. dhe Sh.Q. e datës 18.11.2019, çertifikata e pronësisë P-71914059-01832-7, procesverbali nr.0168801 i KEDS-it, ekspertiza financiar e ekspertit I.P. dt.10.07.2023. Gjykata nga këto prova të administruara dhe sugjerimeve te Gjykatës së Apelit, sipas Aktgjykimit Ae.nr.214/2020 dt.26.11.2021, vërteton se paraardhësi i të paditurit të parë ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e trafostacionit si dhe pëlqimin për rritjen e fuqisë së trafostacionit, i njëjti ka pasur në menaxhim tërë rrjetin 10KV, dhe si rrjedhojë i njëjti është përgjegjës në lidhje me çfardo dëmi i cili mund të krijohet si pasojë e çfardo lloj defekti në këtë trafostacion. Edhe përkundër faktit që nënstationi i energjisë elektrike ka qenë aset privat i cili është investuar nga investitori NTSH Dino, të njëjtit kanë pasur marrëveshje të veçantë sipas së cilës i padituri i parë respektivisht paraardhësi i tij juridik ka marr nën menaxhim tërë rrjetin 10kv përfshi edhe pjesën LP ajror dhe kabllorik. Meqenëse e paditura e parë është kompetente për furnizimin me energjie elektrike, e njëjta ka për detyrim kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ushtrimi i veprimtarisë. Gjykata vlerëson se e paditura e parë mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës dhe duke marrë për bazë faktin se shpërthimi i zjarrit ka ndodh ne procesin e furnizimit me energji elektrike, si pasojë e mbitensionit furnizues i cili ka ardhur nga trafoja shtyllore 10/0.4KV dhe faktit se furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike paraqet veprimtari të rrezikshme, rrjedh se në këtë rast kemi të bëjmë me përgjegjësin objektive për shkaktimin e dëmit. Gjykata vendimin e referon në dispozitën e nenit 136 par.2, 154, 155, 173, 319 të LMD-së. Gjykata ka arsyetuar pjesën e refuzuar të kërkesëpadsisë së paditësit për shumën prej 56,640.01€ në emër të kompensimit të dëmit si pasojë e djegies së objektit duke u referuar ne konstatimet e grupit te eksperteve të ndërtimtarisë në ekspertizën e dt.18.11.2019 dhe plotësimet e saj, që në mënyrë të saktë kanë dhënë konstatimin se lartësia e dëmit e kalkuluar për sipërfaqen prej 501m2 kap vlerën prej 181,246.79€, ndërsa pjesës me të cilën gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë në emër të dëmit si pasojë e djegies së enterierit me paisje teknologjike dhe inventarit në shumën prej 79,042.50€ gjykata po ashtu është bazuar në konstatimin e këtij grupit të ekspertëve të ndërtimtarisë. Paditësi nuk ka ofruar asnjë provë për të argumentuar lartësinë e kompensimit të dëmit të pësuar si

pasoj e djegies së enterierit me pajisje teknologjike dhe inventarit. Gjykata nuk e mori për bazë ekspertizën e ndërtimitarisë nga eksperti S..B. dt.18.01.2019 që i ka tejkualuar kompetencat e veta lidhur me gjendjen faktike. Sa i përket refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit si në pikën II të dispozitivit në emër të fitimit të humbur në vlerë prej 58,155.00€ gjykata është bazuar në konstatimet e dhëna nga eksperti financiar I.P. dt.10.07.2023 i cili në ekspertizën e tij ka dhënë konstatimin se paditësi ka operuar me humbje prej datës 29.08.2014-21.03.2016 andaj nuk është krijuar baza ligjore për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur. Gjykata ia fali besimin ekspertizës së ekspertit I.P. për të cilën ekspertizë palët nuk kanë pasur vërejtje dhe nuk kanë propozuar ekspertizë të re. Gjykata vlerësoi se është i pabazuar pretendimi i paditurës se parë sa i përket legjitimitetit aktiv të paditësit, sepse sipas certifikatës së pronësisë dhe raportit nr.7446-2015 nga komisioni i KEDS-it, është konstatuar se B.M. është pronar i paditësit NH Villa Venera. Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurën e dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, sepse e njëjta nuk ka në pronësi dhe nuk posedon rrjetin elektrik dhe nuk posedon asnjërën nga stabilimentet elektrike, pasi që e njëjta bën vetëm furnizimin me energji elektrike, nga të cilat fakte rezulton se të paditurës së dytë i mungon legjitimiteti pasiv.

Dhomat e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika (n) e LPK, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, apo për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat shkelje pretendohen në dy ankesat e palëve ndërgjyqëse.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar drejt kur me aktgjykimin e atakuar, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, sepse ky aktgjykim gjen mbështetje të mjaftueshme në aspektin e vërtetimit të gjendjes faktike duke marrë për bazë Raportin mbi hulumtimin e shkakut të zjarrit dt.03.09.2015 i lëshuar nga MPB-Agjencia e Menaxhimit Emergjent, e cila në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur zjarri në restorantin Villa Venera në Veternik, ka dhënë mendimin se zjarri është iniciuar nga mbi tensioni prezent në një periudhë të gjatë kohore që ka ndikuar në vjetërsim dhe dëmtim të izolimit në kablllo. Gjithashtu si shkak i ngjashëm i shpërthimit të zjarrit me date 29.08.2015 në objektin e paditësit, kanë nxjerr konstatimin edhe ekspertiza e elektros dt.28.01.2015 nga eksperti G.P., dhe ekspertiza e grupit të ekspertëve R.H., Xh.S. dhe M.B., se si pasojë e mbitensionit furnizues me energji elektrike, e cila ka ardhur nga trafoja shtyllore 10/04.4KV për një periudhë të gjatë kohore kanë shkaktuar shpërthimin e izolimit të kabullit dhe është paraqit harku paralel në mes përcuesit të fazës dhe zeros duke shkaktuar lidhje të shkurt, nga e cila ka reaguuar siguresa 25 Amperëshe në tabelën kryesore shpërndarëse dhe gjendjen e siguresës thikore NHOO 53A në OKK/ormanin kyqës kryesor.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e ligjit material sepse sipas dispozitës së Nenit 136 par.2 të Ligjit mbi detyrimet përcaktohet se “Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajti“.

Kolegji, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka gjykuar përgjegjësin e dëmit të shkaktuar nga e paditura e parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, ndaj paditësit NH Villa Venera, në shumën prej 181,246.79€ në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datën 29.08.2015 si pasojë e djegies së objektit Restaurant Villa Venera, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë 05.11.2025 e deri në pagesën definitive. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se, e paditura e parë Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS SHA me seli në Prishtinë, mban përgjegjësi për faktin se, dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës, dhe se dëmi është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike, gjatë furnizimit të rregullt të paditësit.

Aksidenti ka ndodhur si pasojë e natyrës së veprimtarisë, respektivisht rrezikshmërisë së vazhdueshme që e përcjell këtë veprimtari, e jo nga faktorët e jashtëm. Prandaj, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar bie mbi të paditurën e parë, sepse veprimtaria të cilën e ushtron ajo kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila dallon nga veprimtaritë tjera, gjatë ushtrimit të të cilave të cilave nuk ekziston fare rrezik nga shkaktimi i dëmit. E paditura e parë KEDS-i, ka qenë e obliguar të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e çfarëdo rrezikut, madje është dashur t'i parashoh të gjitha veprimet dhe rrethanat nga të cilat mund të vjen rreziku, dhe të ndërmarrë masa adekuate për evitimin e rrezikut në çdo rrethane dhe nga çdo veprim, mirëpo sikurse shihet nga Raporti i hulumtimit të shkakut të zjarrit dt.03.09.2015 të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent MPB-së, dhe procesverbalit nr.0168801 për shifrën e konsumatorit DPR-... datës 09.01.2014, i padituri i parë KEDS-i, ka nxjerr një konstatim kontradiktor kur ka kryer kontroll në "Hotelin Venera", për faktin se nga gjetjet dhe konstatimet e ekspertit të elektros dt.28.01.2018 nga eksperti G.P., grupit të ekspertëve të elektros R.H., Xh.S. dhe M.B. muaji Tetor 2018, nuk ka dilema se zjarri ka ndodhur si pasojë e mbitensionit furnizues i cili ka ardhur nga trafoja shtyllore 10/0.4KV për një periudhë të gjatë kohore paraprake. Mbitensionet kanë shkaktuar shpërthimin e izolimit të kabullit dhe është paraqitur harku elektrik paralel në mes të përçuesit të fazës dhe zeros duke shkaktuar lidhje të shkurt dhe si pasojë është paraqit zjarri i cili ka djeg objektin.

Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë me të drejt është referuar në dispozitën e nenit 154 të LMD-së, që përcakton: se "Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme, konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari (prezumimi i kuazalitetit), me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit". Prandaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, përgjegjësia e të paditurës së parë KEDS-i, për dëmin e shkaktuar mund të largohet nga ajo, vetëm nëse e paditura e provon se dëmi nuk është shkaktuar nga rryma, apo nëse përkundër faktit se ajo i ka marrë të gjitha masat e duhura, dëmi nuk do të mund të mënjanohej në asnjë mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se dëmi ka ndodhur absolutisht pa fajin e saj dhe se ajo nuk ka mundur ta parashoh dhe as ta parandalojë atë, si dhe të provojë se dëmi ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit. Barra e të provuarit në këtë rast bie mbi të paditurën.

Nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, Kolegji gjeti se e paditura e parë, respektivisht paraardhësi i paditurës së parë, Korporata Elektrokosova- Distribuimi, ka dhënë Pëlqimin elektronergjetik nr.742/1 datës 22.03.2000, të ndërtohet një trafostacion i rendit 10/0.4KV, për furnizim me rryme elektrike për objektin Ars Company-Fabrikë e Betonit, ndërsa me datën 23.04.2009, Korporata Energjetike e Kosovës-Divizioni i Shpërndarjes, ka dhënë Pëlqimin elektro energjetik për rritjen e fuqisë nga 160kv në 250kv konsumatorit NTSH Dino, për trafostacionin e njëjtë, që në pikën e 7 të këtij Pëlqimi parashihet se: KEK ka në dispozicion të vetin menaxhimin në tërë rrjetin 10kv përfshirë edhe pjesën e LP ajror dhe kabllorik të cilin e ka ndërtuar investitori për kyqjen e trafostacionit të vet. Po ashtu KEK do të menaxhoje me një kthinë hyrëse 20/(10)KV, në trafostacionin e ri. Prandaj pretendimet e paditurës së parë KEDS-i se, në ankesë, se trafostacioni nga ku është furnizuar paditësi me rrymë nuk është aset i të paditurës por është aset privat dhe nuk lidhet me mirëmbajtjen dhe përgjegjësin e KEDS-it, Kolegji nga provat e lëndës vërteton se këto janë pretendime të pabazuara sepse e paditura nuk konteston faktet e vërtetuara se e njëjta respektivisht paraardhësja e saj ka lëshuar Pëlqimet elektroenergjetike datës 22.03.2000 dhe 23.04.2009 për ndërtimin e këtij trafostacioni energjetik për furnizim me rryme elektrike dhe rritjen e fuqisë së energjisë elektrike, duke marrë mbi vete përgjegjësin e menaxhimit për tërë rrjetin e këtij trafostacioni të ndërtuar, gjithashtu procesverbali nr.0168801 për shifrën e konsumatorit DPR-... datës 09.01.2014, ku e paditura KEDS-i, bën kontrollin e njehsorit elektrik të paditësit, argumenton se e paditura KEDS-i, ka furnizuar paditësin me energji elektrike, i njëjti ka dhënë pëlqimet për furnizim me energji elektrike, për të cilin i padituri i parë ka pas detyrim ta menaxhoj dhe mirëmbaj.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës KEDS-i, lidhur me mungesën e legjitimitetit aktiv të paditësit për faktin se biznesi i paditësit tanimë në ARBK është shuar si biznes, Kolegji nga shkresat e lëndës nuk ka mund të pranoj këto pretendime si të bazuara sepse me rastin e ndodhjes se zjarrit me datën 29.08.2015 në Restarurantin N.H. Villa Venera në Veternik në Prishtinë, i njëjti ka qene duke ushtruar veprimtarin e biznesit të regjistruar me nr.biznesit 70592096 e regjistruar me datën 03.07.2009 si biznes individual. Kolegji nuk pajtohet me pretendimet ankimore duke interpretuar ligjin në atë mënyrë se dispozita e nenit 48.1 e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. nënkupton se pronari i biznesit individual përgjigjet vetëm për borxhet dhe detyrimet tjera, por nuk mund të përfitoj asnjë të drejt, pas pushimit të saj. Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka arsyetuar të drejtën e kompensimit të paditësit si biznes individual, sepse pronari i biznesit individual si person fizik nuk ka subjektivitet të ndarë nga biznesi individual, dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet lidhur me biznesin individual barten në përgjegjësin e personit fizik, prandaj edhe ligjvënësi në nenin 48 paragrafi 3 i Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, përcakton të drejtat e biznesit individual, që parasheh: *Biznesi individual nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të ketë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emrin e Biznesit Individual apo të pronarit.* Kolegji nga pretendimet ankimore dhe shkresat e lëndës nuk ka mund të vërtetoj datën e shuarjes së paditësit si biznes, për të ardhur te konstatimi se shuarja e biznesit të paditësit ka ndodh para datës kur ka ndodh aksidenti/zjarri në objektin restaurantin e paditësit.

Gjithashtu Dhomat e shkallës së dytë, pranon si të drejta dhe të bazuara në provat e lëndës vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar nga zjarri në objektin e



paditësit, ku gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë mendimin dhe konstatimin e grupit të ekspertëve të ndërtimtarisë N.M., B.M. dhe Sh.Q. të dhënë në ekspertizën e datës 18.11.2019 dhe plotësimet e saj dt.24.02.2020 dhe 17.07.2020, ku është sqaruar mjaftueshëm dhe në mënyrë profesionale se dëmi ka ndodhur në një pjesë të madhe të kulmit dhe instalimeve por jo në mure dhe shtylla dhe teme, dhe ka dhënë mendimin se sipërfaqja e objektit të dëmtuar është 501m<sup>2</sup> bazuar në matjet në terren dhe fotot dhe se vlera e kompensimit të dëmit për këtë sipërfaqe ka shumë prej 181,246.79€. Prandaj Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë nuk i aprovoi pretendimet e paditësit se ky grup i ekspertëve nuk ka dhënë mendimin e tij sa i përket djegies së eneterierit me pajisje teknologjike dhe inventarit në shumë prej 79,042.50€, sepse nuk është provuar nga paditësi, sasia apo kostoja e paisjeve në objektin e djegur nga zjarri, për tu përcaktuar kostoja e paisjeve të dëmtuara. Kolegji nuk i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit se është dashur që gjykata e shkallës së parë t,ia fal besimin ekspertizës së S..B.t, për arsye se kjo ekspertizë e datës 18.01.2019 nga lëmia e ndërtimtarisë, nuk është e plotë, dhe profesionale, pasi që vlerësimi i paisjeve teknologjike dhe inventari në mungesë dokumentacioni, është bërë vetëm me plotësimin e specifikacionit nga paditësi (faqe 11 e ekspertizës).

Kolegji duke vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit, i cili kërkon kompensimin e dëmit në emër të fitimit humbur shumë prej 58,155.00€, për periudhën shtator 2015-mars-2019 në emër të realizimit të përgjithshëm të zvogëlimit për shpenzimet shumë prej 32,655.00€ dhe pagat e 5 punëtoreve për 30 muaj nga 170.00€ shumë prej 25,500.00€ duke e referuar këtë vlerë në ekspertizën e datës 19.08.2019 të ekspertit A.G., dhe në anën tjetër fakti se gjykata e shkallës së parë, ka marrë për bazë ekspertizën financiare datës 10.07.2023 të ekspertit financiar I.P., Kolegji gjen se ekspertiza dhe plotësimi i ekspertit financiar A.G. nuk është hartuar sipas detyrave të përcaktuara nga gjykata dhe është në kundërshtim me provat e lëndës, ndërsa për periudhën kohore 2014-2016 eksperti financiar I.P., ka bërë vlerësimin e qarkullimit financiar të paditësit, ku ka rezultuar se ka operuar me bilanc negativ/humbje paditësi, prandaj nga këto fakte të lartcekura, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës me të drejt ka vendos si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimt të atakuar, kur ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit që e paditura e parë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KEDS-SH.A. me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datën 29.08.2015, si pasojë e djegies së objektit Restaurant Villa Venera, t,ia paguaj paditësit në emër të kompensimit të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumë prej 56,640.01€, në emër të dëmit si pasojë e djegies së enterierit me pajisje teknologjike dhe inventarit shumë prej 79,042.50€ si dhe në emër të fitimit të humbur shumë prej 58,155.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive.

Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur në bazë të vërejtjeve të dhëna me aktgjykimin Ae.nr.214/2020 dt.26.11.2021 të Gjykatës së Apelit, në rigjykim, në pikën III të aktgjykimt të atakuar, ka vendos që të Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.H. Villa Venera, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me datën 29.08.2015, si pasojë e djegies së objektit Restarurant Villa Venera, t,ia paguaj paditësit në emër të dëmit si pasojë e djegies së objektit shumë prej 237,886.80€, në emër të dëmit

si pasojë e djegies se enterierit me paisje teknologjike dhe inventarit shumën prej 79,042.50€, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 58,155.00€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.08.2015 e deri në pagesën definitive. Kolegji nga provat e lëndës, nuk ka mund të konstatoj se edhe e paditura e dytë Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO-SHA me seli në Prishtinë është përgjegjëse për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, dhe paditësi nuk ka provuar me asnjë provë se e paditura e dytë ka nën menaxhim dhe është përgjegjëse e mirëmbajtjes së trafo stacionit energjetik nga ku është furnizuar me energji elektrike paditësi, e që si rezultat i mungesës së këtyre fakteve, më të drejt gjykata e shkallës së parë ka nxjerr konstatimin se të paditurës së dytë i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike.

Dhomat e shkallës së dytë, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë përmes ekspertizave profesionale të mjaftueshme, e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e palë ankuese janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.643/2024 datë 16.05.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari  
Krenar Berisha